

Kushtet e Veçanta për Sigurimin e Jetës me Indeksim - DL051008

Neni 1 - Dispozitat e Përgjithshme

1. Kushtet e Përgjithshme për Sigurimin e Jetës, në vazhdim Kushtet e Përgjithshme, dhe këto Kushte të Veçanta për Sigurimin e Jetës me Indeksim, në tekstin në vazhdim Kushtet e Veçanta, janë pjesë përbërëse e kontratës për sigurimin e jetës, të cilat është kontraktuar indeksimi.
2. Indeksim, me këto kushte, do të thotë harmonizimi i shumës së siguruar me indeksin e çmimeve të shitjes me pakicë, në valutën me të cilën është kontraktuar sigurimi.

Neni 2 - Zbatimi i Indeksimit

1. Indeksimi zbatohet, kur indeksi vjetor i çmimeve të shitjes me pakicë, kumulativisht, rritet së paku 10% krahasuar me indeksin e fundit dhe, pavarësisht nga ky fakt, çdo pesë vjet deri para skadimit të kontratës së sigurimit.
2. Shuma e siguruar, së bashku me shumën e siguruar shtesë për shkak të indeksimeve të mëhershme, me rastin e zbatimit të indeksimit, rritet për një përqindje të njëjtë me rritjen kumulative të indeksit të çmimeve të shitjes me pakicë, krahasuar me indeksin e fundit. Nëse rritja kumulative e indeksit të çmimeve të shitjes me pakicë krahasuar me indeksin e fundit, është më e vogël se 10%, atëherë shumat e siguruara rriten për 10%.
3. Shumat e siguruara të cilat janë rezultat i fitimit të shkruar, nuk indeksohen.
4. Premia shtesë llogaritet në bazë të shumës së siguruar të rritur, tarifave të aplikueshme në ditën e indeksimit dhe kohëzgjatjes së mbetur të sigurimit.

Neni 3 - Ndërprerja e Indeksimit

1. Kontraktuesi i Sigurimit mundet në çfarëdo kohe të kërkojë ndërprerjen e klauzolës për indeksim.
2. Riaktivizimi i klauzolës së indeksimit mundësohet deri në pesë vite para përfundimit të kohëzgjatjes së kontraktuar të sigurimit. Me rastin e riaktivizimit, shuma e siguruar indeksohet duke u bazuar në rritjen kumulative të indeksit të çmimeve të shitjes me pakicë, krahasuar me indeksin e fundit të zbatuar në policën për sigurimin e jetës.

Neni 4 - Zbatimi i Kushteve të Përgjithshme për Sigurimin e Jetës

1. Në kontratat për sigurim të nënshkruara me këto Kushte të Veçanta aplikohen nenet e Kushteve të Përgjithshme për Sigurimin e Jetës.
2. Nëse ka ndonjë mospërputhje në mes të ndonjërës nga dispozitat e Kushteve të Përgjithshme për Sigurimin e Jetës dhe ndonjërën nga dispozitat e këtyre Kushteve të Veçanta, në marrëdhëniet nga kontrata për sigurim do të zbatohen dispozitat nga këto Kushte të Veçanta.